

Lëshimi i prokurave të thjeshta

Përshkrimi

Përpilimi i prokurave të thjeshta nga konsujt për shtetasit shqiptarë me banim jashtë shtetit.

Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Dokument identifikimi si pasaportë ose kartë identiteti biometrike;
- 2) Fotokopje e dokumentit të identifikimit të personit që do të autorizohet;
- 3) Dokumente mbështetëse me të cilat justifikohet mjaftueshëm lëshimi i aktit konsullor (p.sh. librezë pensioni për prokurat për tërheqjen e pensionit).

Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personalisht e personit të interesuar para konsullit ku bëhet verifikimi i identitetit të tij.
- 2) Dorëzimi i mandat-pagesës origjinale të tarifës, që ka derdhur në numrin e llogarisë së përfaqësisë diplomatike ose konsullore të RSH;
- 3) Konsulli përpilon prokurën në dy kopje origjinale;
- 4) Leximi i prokurës nga personi i interesuar;
- 5) Nënshkrimi i prokurës nga konsulli dhe personi i interesuar;
- 6) Njëra prokurë i dorëzohet personit të interesuar;
- 7) Prokura tjetër mbahet në arkivin e ambasadës apo konsullatës së bashku me fotokopjen e prokurës që i është dorëzuar të interesuarit, e cila ka pullën e taksës, si dhe dokumentet mbështetëse të njësuara me origjinalin nga konsulli.

Tarifa e shërbimit dhe afati

20 euro për faqe ose shuma ekuivalente në monedhën vendase.

Prokura përpilohet në momentin që paraqitet i interesuari.

Zyra

Të gjithë përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

Shënime

Vlefshmëria e prokurës është e kufizuar deri në një vit.

Postet konsullore kryejnë veprime në cilësinë e noterit vetëm për shtetasit shqiptarë që banojnë në juridiksionin që mbulon përfaqësia diplomatike apo konsullore.

Për prokurat e tjera që nuk lëshohen nga postet konsullore, personat e interesuar i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri prokurat e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj

Postet konsullore nuk përpilojnë prokura të përgjithshme ose që kanë të bëjnë me kalimin e pronësisë, të sendeve të luajtshme apo të paluajtshme, për të cilat regjistrimi i tyre kërkohet shprehimisht nga ligji.

Në vendet që nuk ka Ambasadë apo Konsullatë shqiptare, të interesuarit i drejtohen noterëve vendas. Për t'u njohur nga autoritetet në Shqipëri prokurat e noterëve vendas duhet të legalizohen ose apostilohen, si çdo dokument tjetër i huaj.